

LAVDIMIR FUSHA
EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR
Kod Fiskal 3904585
License Profesionale Nr. 97 Date 13.12.2000



Tirane, më 25 Tetor 2005

RAPORT I BASHKIMIT

Në zbatim të vendimeve Nr. 8 date 27.09.2005 i Ortakut të Vetem të shoqërisë "VEGA" shpk. Tirane dhe Nr. 2 date 27.09.2005 të shoqërisë "2-AL" shpk. Tirane, si dhe vendimet respektive Nr. 21932/8 date 20.10.2005 dhe 27899/2 date 20.10.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, për vlerësimin e kapitaleve të shoqërisë "2-AL" shpk Tirane, që kalojnë në shoqërinë "VEGA" shpk Tirane me rastin e bashkimit me thithje në këtë të fundit dhe vlerësimin e kapitaleve të shoqërisë përthithëse "VEGA" shpk Tirane, unë Lavdimir Fusha, Ekspert Kontabël i Autorizuar paraqes Raportin tim si më poshtë:

a) Shoqëritë pjesëmarrëse në bashkimin me thithje janë:

1. Shoqëria "2-AL" shpk Tirane, shoqëria e përthithur

- Forma juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ;
- Emërtimi: "2 -AL" shpk. Tirane ;
- Selia legale: Rruga "Gjik Kuçali", Pallati Nr. 2, Tirane ;
- Regjistruar në regjistrin tregtar me Vendimin e gjykatës Nr. 27889 datë 10.06.2002 ;
- Kod Fiskal Nr. 503804, NIPT K32306002D ;
- Zotëruar 100 % nga z.Ethem DUBALI, person fizik shqiptar;
- Me objekt veprimtarie : Export-Import, tregtimi mallrash me shumice dhe pakice.

2. Shoqëria "VEGA" shpk Tirane , shoqëria përthithëse

- Forma juridike: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ;
- Emërtimi: "VEGA" shpk. Tirane ;
- Selia legale: Rruga "Lidhja e Prizerenit", Tirane ;
- Regjistruar në regjistrin tregtar, me Vendimin e Gjykatës Nr. 21832 datë 19.08.1998 ;
- Zotëruar 100 % nga z. Aleksander GAVOCI, persona fizik shqiptar.

- Me objekt veprimtarie: Export - Import, ndertim dhe tregtimi mallrash me shumice dhe pakice.

b) Vlerësimi i aktivitet dhe pasivitet te shoqërisë "2 - AL" shpk. Tirane, që i kalojnë shoqërisë përthithëse "VEGA" shpk. Tirane.

Kalimi i aktiveve e pasiveve të shoqërisë "2 - AL" shpk Tirane, në bilancin e shoqërisë "VEGA" shpk Tirane, bëhet sipas gjendjes së tyre me datën 31 Gusht 2005.

Për vlerësimin e aktiveve e pasiveve të shoqërisë "2 - AL" shpk Tirane janë përdorur kriteret e përcaktuara në Ligjin nr **7661** datë **19.1.1993** "Për Kontabilitetin", nenet **59** deri **70**, dhe në Planin Kontabël të Përgjithshëm, Kapitulli III Rregullat e vlerësimit:

- Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara: me koston historike të paksuar me amortizimet sipas normave fiskale.
- Gjendje te inventarit dhe ne proces : me koston e marrjes.
- Të drejtat mbi të tretët: me vlerat nominale sipas kontabilitetit.
- Detyrimet: me vlerat nominale sipas kontabilitetit.

Gjendja e vlerësimi i aktiveve dhe pasiveve :

AKTIVI

I- Aktive te qendrueshme te trupezuara

Nr.	EMERTIMI I A.Q.TRUPEZUARA	Vlera me Kosto historike	Amortizimi I akumuluar	Vlera e Mbetur (neto)
1	Toka,troje terrene	0	0	0
2	Ndertime e instalime pergjithshm	0	0	0
3	Makineri, paisje, e vegla pune	0	0	0
4	Mjete transporti	0	0	0
5	Te tjera ne shfrytezim	0	0	0
	TOTALI	0	0	0

Nga auditimi u siguroam se nuk disponon asete AQT.

Guo 19 05

II. Gjendje te inventarit dhe ne proces

Nuk ka.

III. Kërkesa për arkëtim mbi debitorët

- Kliente per shitje e sherbime 706,824 leke, ekzistojne dhe jane me shprese arketimi.
- "Ortak" per shumen 576,031leke, detyrim i ortakut ndaj shoqerise dhe te "Te tjera" 423,969 leke, te analizuara dhe me shprehs arketimi.
- Të tjera kerkesa, Tatim Fitimi per shumen 1,392,848 lekë, qe perfaqson detyrimin e organit tatimor ndaj shoqerise per tatim fitimi derdhur me teper respektivisht per vitin ushtrimor 01 Janar 31 Gusht 2005 per shumen 500,000 leke dhe para vitit ushtrimor 2005 ne shumen 892,848 leke.

IV. Likujditete:

a. Gjithsej gjendja ne banka	56,696 leke
b. Para ne dore (Arke)	40,888 leke
Gjithesej likujditete (a+b)	97,584 leke

Nga auditimi u siguruam se tepericat e paraqitur ne Bilanc me 31 Gusht 2005, jane te njehta me inventarin e arkës dhe me ekstratet e bankave.

Totali i aktiveve (I + II + III + IV +V)	3,197,256 lekë
---	-----------------------

PASIVI**I. Detyrimet**

Afat shkurtëra:

- Huara nga bankat dhe institutet e kreditit 2,200,000 leke
- Shteti-tatime e taksa 9,250 lekë

- Furnitore per blerje e sherbime	382,029 leke
- Sigurime shoqerore	29,946 lekë
--Gjithsej detyrime afat shkurtëra	2,621,225 lekë

II. Kapitalet e veta (TOTAL AKTIVI - DETYRIME PASIVI)

Kapitali i themelimit	100,000 lekë
Rezerva ligjore	0 lekë
Rezerva statutore	0 lekë
Fitime dhe humbje të mbartura	3,270,660 lekë
Fitime dhe humbje të ushtrimit (viti 2005)	-2,794,635 lekë

--Gjithsej kapitale të veta **576,031 lekë**

Totali i pasiveve (I + II)	3,197,256 lekë
-------------------------------------	-----------------------

Për të gjitha llogaritë sintetike të të drejtave e detyrimeve disponohen analizat përkatëse të verifikuara dhe te rakorduara.

c) Vlerësimi i aktivitet dhe pasivit te shoqerise "VEGA" shpk. Tirane , që perthithe shoqërinë "2 – AL" shpk. Tirane.

Gjendja e aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë "VEGA" shpk Tirane, që perthithe bilancin e shoqërisë "2-AL" shpk Tirane, bëhet sipas gjendjes së tyre me datën 31 Dhjetor 2004.

Për vlerësimin e aktiveve e pasiveve të shoqërisë "VEGA" shpk Tirane, janë përdorur te njejtat kritere si ne vleresimin e shoqerise "2 – AL" sh.p.k. Tirane.

Alshin, z

Gjendja e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise perthithese "VEGA" shpk. Tirane, paraqitet si me poshte :

AKTIVI	Vlera Ne Leke	PASIVI	Vlera Ne Leke
B.Aktive te Qendrueshme	29,030,100	A.Kapitalet e Veta	37,066,563
1.Te pa Trupezuara	123,600	I.Kapitali Themelltar	37,066,563
a.Shpenzime te nisjes	247,200		
b.Amortizime (-)	123,600		
2.Te Trupezuara	28,906,500	a.Kapitali i Nenshkruar	37,000,000
a.Toka, Troje, Ndert. Inst. pergj.	-	b.Prime te lidhura	-
b.Instal.teknike,makine,paisje	39,529,146	c.Diferenca rivleresimi	-
c.Te tjera ne shfrytezim	1,451,155	d.Rezervat	66,563
e.Amortizime (-)	-12,073,801	e.Fitime/H. te mbartura	-
C.Aktive Qarkulluese	305,394,093	h.Fitime/H. te ushtrimit	-
I.Gjendje inventari e ne proces	301,924,123	B.DETYRIME	297,357,630
a.Materiale te para e tjera		I.Detyrime mbi 1 Vit	116,700,000
b.Prodhime,punime ne proces	289,524,123	h.Ortake	116,700,000
c.Produkte dhe mallra	12,400,000	f.Te tjera detyrime	-
II.Kerkesa mbi debitoret	2,046,209	II.Detyrime deri 1 Vit	180,657,630
a.Klient per shitje e sherbime	111,515	a.Huara nga bankat	85,512,941
b.Ortake kapital I pa derdhur	-	b.Arketime me porosi	63,476,113
c.Personeli dhe persona	-	d.Furnitor per blerje	21,524,212
d.Te tjera kerkesa	1,934,694	e.Personeli	-
III.Likujditete	1,423,761	h.Sigurime shoqerore	570,996
a.Depozita ne banke	8,961	f.Shteti tatime e taksa	148,965
b.Para ne dore (arke)	1,414,801	g.Ortake	9,369,403
c.Vlera arke te tjera	-	i.Te tjera detyrime	55,000
D.Llogari te tjera	-	C.Llogari te tjera	-
TOTALI I AKTIVIT	334,424,193	TOTALI I PASIVIT	334,424,193

Ne perfundim te verifikimeve dhe kontroleve, jam ne gjendje te vertetoj se gjendja e llogarive me date 31 Dhjetor 2004 qe i aneksohen ketij raporti jane te sinqerta dhe te rregullta dhe japin nje pamje besnike te gjendjes FINANCIARE e PASURORE te shoqerise perthithese "VEGA" shpk. Tirane.

Shkollë S

ç) Mënyra e dorzimit të pjesëve të kapitalit themeltar dhe data pas së cilës këto pjesë japin të drejta pjesëmarrjeje.

Shoqëria "2-AL" shpk Tirane me kapital themeltar 100,000 leke, të zotëruar 100 % nga Ortaku i vetëm z. Ethem DUBALI. Në këtë kuptim, nga thithja kjo shoqëri kontribon me kapitale në shoqërinë përthithëse "VEGA" shpk. TIRANE.

Me hyrjen në fuqi të bashkimit me thithje të gjitha detyrimet dhe të drejtat e shoqërisë "2-AL" shpk Tirane ndaj të tretëve i merr përsipër shoqëria "VEGA" shpk. Tirane. Gjithashtu të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kapitali për pjesëmarrje në fitimet e shoqërisë "VEGA" shpk pas bashkimit i takojnë Ortakut të kësaj shoqërie.

Në aspektin e kontabilitetit, data pas së cilës operacionet e shoqërisë së përthithur "2-AL" shpk Tirane dhe asaj përthithëse "VEGA" shpk Tirane do të konsiderohen të kryera është 31.08.2005.

d) Datat e hartimit të llogarive.

Datat, për formulimin e kushteve të operacionit të bashkimit me thithje do të jenë : Per shoqërinë e përthithur "2-AL" shpk Tirane 31 Gusht 2005 dhe për shoqërinë përthithëse "VEGA" shpk Tirane 31 Dhjetori 2004.

dh) Raporti i këmbimit të të drejtave në shoqëri.

Duke ju referuar në të dhenat e BILANCEVE për të dyja shoqëritë vecmas, në vendimet e asambleve dhe në projektin e bashkimit, konstatohet kjo situatë e kapitaleve të veta dhe kjo e drejtë zoterimi në kapital :

1. Për shoqërinë që përthithet "2-AL" shpk Tirane

Kapitalet e veta	576,031 leke
Sipas këtij objekti klasifikimi,	
a. Kapitali i nënshkruar	100,000 leke

Shoqëria

I Zoteruar nga,

Ethem DUBALI 100 %	
b. Fitime dhe Humbje te mbartura	3,270,660 leke
c. Fitime dhe Humbje te ushtrimit	- 2,794,635 leke

2. Per shoqerine perthithese "VEGA" shpk Tirane

Kapitalet e veta	37,066,562.80 leke
Sipas ketij objekti klasifikimi,	
a. Kapitali i nenshkruar	37,000,000.00 leke

I zoteruar nga,

Aleksander GAVOCI 100 %	
b. Rezervat	66,562.80 leke

Bazuar ne te dhenat e mesiperme mendoj, se ka vend per raporte kembimi e per llogaritje shumash per te kompesuar pabarazine e te drejtave te kembjera, realizimin e te ciles po e paraqes me poshte :

Llogaritja e Raportit te kebimit (Rk.)

Shoqerite shpk	Shuma e Kapitalit themeltar	Numeri i Pjeseve	Vlera nominale e nje pjese	Vlera e shoqerise (e nxjerre nga vleresimet)	Vlera per njesi e pjeseve
a	1 (2x3)	2	3	4	5 (4 : 2)
"VEGA"	37,000,000	100	370,000	37,066,563	370,665
"2-AL"	100,000	100	1,000	576,031	5,760

Raporti i kebimit rezulton :

$$Rk = 370,665 : 5,760 = 64.35 \text{ me } 1$$

Ky raport tregon se 64.35 pjese te shoqerise "2-AL" shpk Tirane, jane te berabarta me 1 pjese te kapitalit te shoqerise "VEGA" shpk Tirane,

$$(64.35 \times 5,760 = 370,665) = (1 \times 370,665 = 370,665).$$

Arshia E

Bazuar ne raportin e kembimit te mesiperm, dhe ne projektin e bashkimit ku ne Vendimet e marra eshte vendosur se ne Shoqerine e re qe krijohet nga kjo procedur do te jete Ortak i Vetem z. Aleksander GAVOCI, si dhe Ortaku i Vetem i shoqerise se perthithur "2-AL" shpk Tirane z. Ethem DUBALI, heq dore nga pjesmarrja ne kapitalin e shoqerise perthithese "VEGA" shpk Tirane. Zotit Ethem DUBALI i takon te kompensohet sipas bilancit te shoqerise qe perthithet "2-AL" shpk Tirane me vleren e kapitaleve te veta (aktive neto) per shumen 576,031 leke, qe realisht eshte terhequr prej tij, dhe paraqitet ne aktivin e bilancit ne rubriken "III.Kerkesa per arketim mbi debitorët" postit "ORTAKE, detyrime te ortakut ndaj shoqerise".

Duke pasur ne konsiderat : Kapitalin e shoqerise perthithese qe behet 37.100,000 leke mbase bashkimit te te dy shoqerive (mbase kryerjes se operacionit te bashkimit), pjesmarrja ose zoterimi i kapitalit themeltar te nenshkruar do te jete :

Z. Aleksander GAVOCI	37,100,000 leke ose 100 %
TOTALI	37,100,000 leke ose 100 %

e). BILANCI I BASHKIMIT te shoqerive.

Bilanci i Bashkimit ose bilanci i shoqerise perthithese "VEGA" shpk Tirane, realizohet si bashkim matematikor i bilanceve te vecanta dhe paraqitet si vijon:

AKTIVI	Vlera Ne Leke	PASIVI	Vlera Ne Leke
B.Aktive te Qendrueshme	29,030,100	A.Kapitalet e Veta	37,066,563
1.Te pa Trupezuara	123,600	I.Kapitali Themeltar	37,642,594
a.Shpenzime te nisjes	247,200		
b.Amortizime (-)	123,600		
2.Te Trupezuara	28,906,500	a.Kapitali i Nenshkruar	37100,000
a.Toka,Troje,Ndert.Inst.pergj.	-	b.Prime te lidhura	-
b.Instal.teknike,makine,paisje	39,529,146	c.Diferenca rivleresimi	-
c.Te tjera ne shfrytezim	1,451,155	d.Rezervat	66,563
e.Amortizime (-)	-12,073,801	e.Fitime/H. te mbartura	3,270,660
C.Aktive Qarkulluese	308,591,349	h.Fitime/H. te ushtrimit	- 2,794,635
I.Gjendje inventari e ne proce	301,924,123	B.DETYRIMET	299,978,855

Handwritten signature

a.Materiale te para e tjera		I.Detyrime mbi 1 Vit	116,700,000
b.Prodhime,punime ne proces	289,524,123	h.Ortake	116,700,000
ç.Produkte dhe mallra	12,400,000	f.Te tjera detyrime	-
II.Kerkesa mbi debitoret	5,145,881	II.Detyrime deri ne 1 Vit	183,278,855
a.Klient per shitje e sherbime	818,339	a.Huara nga bankat	87,712,941
b.Ortake kapital I pa derdhur	1,000,000	b.Arketime me porosi	63,476,113
c.Personeli dhe persona	-	d.Furnitor per blerje	21,906,241
d.Te tjera kerkesa	3,327,542	e.Personeli	-
III.Likujditete	1,521,346	h.Sigurime shoqerore	600,942
a.Depozita ne banke	65,657	f.Shteti tatime e taksa	148,965
b.Para ne dore (arke)	1,455,689	g.Ortake	9,369,403
c.Vlera arke te tjera	-	i.Te tjera detyrime	64,250
D.Llogari te tjera	-	C.Llogari te tjera	-
TOTALI I AKTIVIT	337,621,450	TOTALI I PASIVIT	337,621,450

Për të gjitha llogaritë sintetike të të drejtave e detyrimeve disponohen analizat përkatëse të verifikuara e rakorduara.

Mbështetur në nenin 246 të Ligjit nr 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", data e hyrjes në fuqi të bashkimit do të jetë data 31.08.2005.



Për efekte kontabile, bilancet e vecanta, janë bashkuar në një bilanc të vetëm, i cili do të jetë edhe bilanci zyrtar i shoqërisë "VEGA" shpk. Tirane, i cili do të shërbejë si celje për ushtrimin 01.01.2005 deri me 31.12.2005, ose Bilanci i shoqërisë "VEGA" shpk Tirane të mbyllur me 31.12.2004 të celet me 01.01.2005 dhe me veprime kontabile të shtohet bilanci i shoqërisë së perthithur "2-AL" shpk Tirane të mbyllur me 31 Gusht 2005.

Ne kete operacion jane pasur ne konsiderat dhe jane arzhonuar edhe efektet fiskale për periudhen 01.01.2005 deri me 31 Gusht 2005 për shoqërinë që perthithet "2-AL" shpk. Tirane.

Për sa më lart, nga vlerësimet e aktiveve e pasiveve të shoqërisë "VEGA" shpk Tirane, që rezultojnë nga operacioni i bashkimit me perthithje me shoqërinë "2-AL" shpk.Tirane, konkludojmë se ato janë konformë legjislacionit në fuqi.

Tirane, 25 Tetor 2005

LAVDIMIR FUSHA

Ekspert Kontabël i Autorizuar